

Pyetja 13 **2 pikë**

- Nxënësi justifikon mendimin e tij duke iu referuar me saktësi stilit të përdorur në tekst. Përgjigjja mbështetet në një aspekt të stilit, që mendohet se do të tërheqë kandidatë të mundshëm për një punë në këtë studio fotografike. Nxënësi duhet të përdorë fjalë të tilla si: “i lehtë për t’u kuptuar/lexuar”, “i qartë”, “interesant”, “i besueshëm”, “tërheqës”.
- Po, sepse është shkruar në një mënyrë shumë të çlirët.
 - Ky tekst do t’u interesonte padyshim personave që duan të marrin pjesë në një punë vere, pasi autori përpiket të japë shpjegime shumë të detajuara rreth saj.
 - Teksti është shkruar në mënyrë shumë miqësore, sikur dikush po bisedon me ty.
 - Teksti është shumë i qartë.
- I referohet më tepër përmbajtjes, sesa stilit të tekstit.
- Po, sepse u jep kandidatëve të mundshëm informacion të detajuar për të marrë pjesë në një punë vere.
 - Po, sepse në këtë studio mund të mësohet shumë gjëra, që lidhen me profesionin e fotografit ose karrierën tënde të ardhshme.

2 pikë Nëse i referohet stilit të përdorur në tekst.

OSE

1 pikë Nëse i referohet vetëm përmbajtjes së tekstit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II**Bajroni****Çajld Harold (Kënga e lamtumirës)**

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë**➤ **Gjendja shpirtërore**

- Heroi lirik shfaqet i trishtuar, i dëshpëruar, i zhgënjyer.

➤ **Ilustrimet:**

- *Në botë mbeta fill i mjerë, për mua s’qau njeri, mbeta fill i mjerë, Në vatrën time nuk ka zjarr etj*

1 pikë Nëse përshkruan me pak fjalë gjendjen shpirtërore të heroit.

DHE

1 pikë Nëse përgjigjen e ilustron me një shembull nga poezia.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **2 pikë**

➤ **Motivet:**

- zhgënjimi, pakënaqësia nga realiteti në vendin e tij;
- zhgënjimi nga jeta personale;
- vetmia.

2 pikë Nëse identifikon dy motivet e largimit të heroit nga vendlindja.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një motiv të largimit të heroit nga vendlindja.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 **2 pikë**

➤ **Analiza e plotë**

- Vargjet japin thelbin e zhgënjimit dhe vetmisë së heroit. Pakënaqësia është e dukshme. Haroldin nuk e trembin rreziqet me të cilat mund të përballet në jetë, as gëzimet që shkojnë e vijnë, por vetëdija që s'i ka mbetur më askush pranë, që t'ia vlejë të vajtojë për të, t'i mungojë. Bie në sy theksimi i fjalës *asnjë* që nënvizon pikërisht këtë vetmi dhe zhgënjim.

Analiza e pjesshme

- Janë vargje ku theksohet dëshpërimi, vetmia e heroit.

2 pikë Nëse analizon në mënyrë të plotë vargjet e dhëna.

1 pikë Nëse analizon në mënyrë të pjesshme vargjet e dhëna.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (a) 3 pikë➤ **Vargjet.**

Pra, merrmë, o lundër, dhe vrapo
në detin plot buçim;
dhe shpërmë në çdo vend që do,
veç jo në vendin tim!

➤ **Vendimi:** të mos kthehet më në vendin e tij.➤ **Analiza**

- Vendimi i marrë tregon një gjendje shpirtërore tejet të rënduar, që ka arritur kulmin e dëshpërimit. Kemi një njeri që s'e ka problem të shkojë kudo, veç në vendin e tij jo.

OSE

- Në nëntekst ai mohon vendin e tij. Kjo tregon për një dëshpërim të skajshëm që vjen si pasojë e një zhgënjimi të madh, shkaktuar nga miqtë, njerëzit e afërm, tërë mjedisi.

1 pikë Nëse identifikon vargjet.

1 pikë Nëse tregon vendim që merr hero i lirik.

1 pikë Nëse analizon gjendjen e heroit lirik në këtë moment.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 (b) 2 pikë➤ **Romantik**

- **Poeti shfaqet romantik:** kemi një hero të vetmuar, të zhgënjyer dhe të pakënaqur nga realiteti. Gjatë gjithë kohës spikat gjendja e tij shpirtërore.

1 pikë Nëse tregon si shfaqet poeti.

1 pikë Nëse shpjegon pse është romantik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (a) 2 pikë

- **Kuptimi i drejtpërdrejtë** i fjalës *zjarr*: në shtëpi s'ka njerëz, s'është ai, s'ka zjarr në vatër.
- **Kuptimi i figurshëm:** mungon ngrohtësia njerëzore, ndihet braktisja, vetmia. Zjarri, si element i jetës, mungon.

1 pikë Nëse tregon kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës *zjarr*.

1 pikë Nëse tregon kuptimin e figurshëm të fjalës *zjarr*.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 (b) 2 pikë

Përgjigje e lirë

- Përgjigja mund të fokusohet në konstatimin elementeve të përmbajtjes: ndjenja që sundon, dëshpërimi, braktisja, fryma romantike etj.
- Përgjigja mund të fokusohet në konstatimin e elementeve të stilit në fragment: figuracioni, sa interesante, e ndjeshme, e ngrohtë perceptohet ajo (poezia).

1 pikë Nëse tregon se çfarë i bën përshtypje.

1 pikë Nëse shpjegon se pse i bën kaq përshtypje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.
